ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K. Regj. e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KRMP-26-4341-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me kontejnera te ri metalik njesia Operative Prizren**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**N.P.T. HAXHIJAHA SH.P.K.**
NUI	**810396772**
Adresa	**Xhelal Hajda - Toni**
Vendi	**Rahovec**
Kodi postar	**162**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Shkumbin Haxhijaha**
Adresa elektronike	**info@haxhijaha.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**12.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi me kontejnera te ri metalik njesia Operative Prizren

1. **Njoftim per Kontrat – 05.06.2026**
2. **Procesverbali i hapjes: 27.07.2026**
3. **NJOFTIMI PER VENDIMIN E AK: 02.11.2026**
4. **Kerkesa per rishqyrtim: 06.11.2026**
5. **Pergjigje ne kerkes per rishqyrtim: 09.11.2026**
6. **Ankesa ne OSHP: 12.11.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Nuk pajtohemi me vendimin e AK-se

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Sipas Nenit 108/A te ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ankesa mund të dorëzohet, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Ne konsiderojm qe AK ka shkelur dispozitat ligjore ne keto Nene:

Neni 1: Qëllimi

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60: Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bashkëngjitur me këtë ankesë gjendet kërkesa jonë për rishqyrtim e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues, si dhe vendimi/përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës sonë.

Ne nuk pajtohemi me konstatimet dhe arsyetimin e Autoritetit Kontraktues, pasi konsiderojmë se faktet dhe dokumentacioni i dorëzuar në këtë aktivitet të prokurimit dëshmojnë se oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pretendimet tona i paraqesim dhe i argumentojmë si në vijim.

II. PRETENDIMI NR. 1 – MOSPËRPUTHJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIK PËR

KONTEJNERIN 7 mł

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, ka paraqitur katër arsye mbi bazën e të cilave pretendimin tonë e ka cilësuar si të pabazuar.

Ne, si Operator Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, nuk pajtohemi me këto konstatime, pasi nga shqyrtimi objektiv i dokumentacionit të ofertës së GOE-së së rekomanduar për kontratë rezultojnë mospërputhje të qarta, materiale dhe të verifikueshme ndërmjet dokumenteve të dorëzuara prej tyre.

Konkretisht, dokumentacioni mbi specifikat teknike i dorëzuar nga GOE-ja është në kundërshtim ndërmjet veti.

Fillimisht, Deklarata e Specifikacionit Teknik rezulton të jetë plotësuar duke përsëritur kërkesat e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, ndërsa dokumentet që do të duhej t'i vërtetonin këto deklarime, përkatësisht vizatimet teknike dhe dokumentacioni i certifikimit, paraqesin të dhëna të ndryshme.

Për kontejnerin metalik me kapacitet 7 mł, në Deklaratën e Specifikacionit janë deklaruar dimensionet: 3300 mm × 1820 mm × 1400 mm. Ndërkaq, në vizatimet teknike të bashkëngjitura nga i njëjti GOE paraqiten dimensione: 3325 mm × 1900 mm × 1500 mm.

Pra, kemi një mospërputhje të drejtpërdrejtë ndërmjet dimensioneve të deklaruara në Deklaratën e Specifikacionit dhe dimensioneve të paraqitura në vizatimin teknik të produktit. Kjo mospërputhje nuk mund të konsiderohet thjesht si çështje formale, pasi vizatimet teknike janë kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues si dëshmi për vërtetimin e karakteristikave teknike të produktit të ofertuar.

Për më tepër, në Dosjen e Tenderit është kërkuar edhe certifikimi përkatës sipas standardit DIN 30720. GOE-ja e rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar këtë dokumentacion, mirëpo edhe brenda tij evidentohen të dhëna të tjera që nuk përputhen me Deklaratën e Specifikacionit.

Konkretisht, në faqen nr. 6 të dokumentacionit/certifikatës DIN 30720, në vizatimin teknik të kontejnerit paraqiten: Gjatësia: 3620 mm, Lartësia: 1500 mm

Këto dimensione janë përsëri të ndryshme nga dimensionet 3300 mm × 1820 mm × 1400 mm të deklaruara në dokumentin me numër rendor 4.1 – Deklarata e Specifikacionit.

Rrjedhimisht, për të njëjtin produkt, në ofertën e GOE-së së rekomanduar për kontratë paraqiten së paku tri versione të ndryshme të dimensioneve:

Deklarata e Specifikacionit: 3300 × 1820 × 1400 mm;

Vizatimi teknik i bashkëngjitur: 3325 × 1900 × 1500 mm;

Dokumentacioni/certifikata DIN 30720: gjatësi 3620 mm dhe lartësi 1500 mm.

Nga këto të dhëna është e pamundur të konstatohet në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se cili është produkti realisht i ofertuar dhe cilat janë karakteristikat e tij faktike.

Pikërisht për këtë arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë ligjore që një ofertë me dokumentacion teknik kontradiktor ta konsiderojë si ofertë të përgjegjshme.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së, një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një gabim formal apo devijim të parëndësishëm, por me mospërputhje ndërmjet dokumenteve që kanë për qëllim pikërisht vërtetimin e specifikave teknike të produktit të ofertuar.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të marrë si të mirëqenë vetëm Deklaratën e Specifikacionit dhe njëkohësisht të injorojë dokumentet teknike të dorëzuara nga vetë ofertuesi, kur këto dokumente paraqesin karakteristika të ndryshme të produktit.

Nëse një OE deklaron një karakteristikë teknike, por dokumenti që duhet ta dëshmojë atë karakteristikë paraqet të dhëna të tjera, atëherë deklarata nuk mund të konsiderohet e vërtetuar.

Prandaj, konsiderojmë se GOE-ja e rekomanduar për kontratë është dashur të cilësohet si e papërgjegjshme për shkak të mospërputhjes së dokumentacionit teknik dhe të eliminohet nga procedura e mëtejshme e vlerësimit.

III. PRETENDIMI NR. 2 – MOSRESPEKTIMI I VENDIMIT TË OSHP-së NR. 2026/0410 LIDHUR ME KËRKESËN PËR MOSTRA

Për të njëjtin aktivitet të prokurimit, çështja ka qenë më parë objekt shqyrtimi pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në Vendimin nr. 2026/0410, Paneli Shqyrtues ka përcaktuar, ndër të tjera, se: “AK-ja do të mund të kërkonte mostrat vetëm për operatorin ekonomik i cili synohet të shpërblehet me kontratë para publikimit të B58 – Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, e jo si kusht paraprak për të gjithë tenderuesit.”

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë procesit të rivlerësimit, nuk e ka zbatuar në

mënyrë të drejtë dhe efektive këtë konstatim të Panelit Shqyrtues.

Shkelja manifestohet në dy aspekte:

1. GOE-ja e rekomanduar për kontratë është dashur fillimisht të kalojë vlerësimin e dokumentacionit. Nga dokumentacioni teknik i analizuar më lart rezultojnë mospërputhje të qarta ndërmjet Deklaratës së Specifikacionit, vizatimeve teknike dhe dokumentacionit DIN 30720. Në këto rrethana, GOE-ja është dashur të shpallet e papërgjegjshme që në fazën e vlerësimit të dokumentacionit. Për rrjedhojë, një operator i cili nuk i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit në bazë të dokumentacionit të ofertës së tij nuk do të duhej të arrinte fare në fazën e kërkesës dhe vlerësimit të mostrës. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar këtë GOE për kontratë duke u mbështetur, ndër të tjera, në konstatimin se Komisioni për Vlerësimin e Mostrave ka konstatuar se mostra i përmbush specifikat teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Një arsyetim i tillë, sipas vlerësimit tonë, e zhvendos në mënyrë të palejuar procesin e vlerësimit nga dokumentacioni i ofertës te mostra fizike. Mostra nuk mund të shërbejë për të korrigjuar, zëvendësuar apo rehabilituar një ofertë e cila, në momentin e dorëzimit të tenderit, përmban dokumente teknike kontradiktore dhe nuk dëshmon qartë përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Në të kundërtën, do të mundësohej që një operator të dorëzojë dokumentacion teknik jo të rregullt dhe më pas, përmes paraqitjes së një mostre, të korrigjojë mangësitë materiale të ofertës së tij pas afatit të dorëzimit të tenderëve, gjë që cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

2. Mostra është kërkuar edhe nga ne, ndonëse nuk ishim operatori i synuar për dhënie të kontratës. Edhe nga ne, si Operator Ekonomik ankues, është kërkuar paraqitja e mostrave të kontejnerëve para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Kjo mënyrë e veprimit bie ndesh me përmbajtjen dhe qëllimin e Vendimit nr. 2026/0410, ku është përcaktuar se mostra mund të kërkohet vetëm nga operatori ekonomik të cilit synohet t'i jepet kontrata dhe jo si kusht paraprak për të gjithë tenderuesit. GOE-ja e propozuar për kontratë ka paraqitur ofertën me çmimin më të ulët nga të gjithë operatorët pjesëmarrës. Ne jemi renditur si operatori i dytë sipas çmimit. Prandaj, nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se GOE-ja me çmimin më të ulët ka qenë plotësisht e përgjegjshme pas vlerësimit të dokumentacionit të ofertës, atëherë, në pajtim me Vendimin nr. 2026/0410, nuk ka pasur arsye që mostra të kërkohej edhe nga ne.

Fakti që mostra është kërkuar edhe nga ne krijon pikërisht situatën të cilën Vendimi nr. 2026/0410 ka synuar ta evitojë – kërkimin e mostrave nga më shumë tenderues si kusht i procesit të vlerësimit, në vend që mostra të kërkohet vetëm nga operatori që, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, synohet të rekomandohet për kontratë. Nga kjo rezulton një kontradiktë e qartë në veprimet e AK-së:

nëse GOE-ja e parë ka qenë e përgjegjshme, mostra është dashur të kërkohet vetëm prej

saj; nëse AK-ja ka konsideruar të nevojshme kërkimin e mostrës edhe nga operatori i renditur i dyti, atëherë vetë ky veprim tregon se procesi i identifikimit të operatorit të synuar për kontratë nuk kishte përfunduar. Në të dyja rastet, konsiderojmë se mënyra e veprimit të Autoritetit Kontraktues nuk është në përputhje me Vendimin nr. 2026/0410.

IV. MOSPËRPUTHJA NDËRMJET OFERTËS DHE MOSTRËS NUK MUND TË ANASHKALOHET

Theksojmë se një mostër e paraqitur pas dorëzimit të tenderit nuk mund ta ndryshojë përmbajtjen e dokumentacionit teknik që ka qenë pjesë e ofertës në momentin e hapjes. Vlerësimi i përgjegjshmërisë duhet të bëhet mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar brenda afatit të tenderimit dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Përderisa dokumentacioni i GOE-së përmban dimensione dhe të dhëna teknike të ndryshme për të njëjtin kontejner, nuk mund të konstatohet se në momentin e ofertimit ai operator ka dëshmuar në mënyrë të qartë plotësimin e kërkesave teknike. Prandaj, konstatimi i komisionit se mostra fizike i plotëson specifikat nuk mund të përdoret si bazë për të anashkaluar mospërputhjet ekzistuese në ofertën origjinale.

V. SHKELJA E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË DHE VLERËSIMIT OBJEKTIV

Në procedurat e prokurimit publik, të gjithë Operatorët Ekonomik duhet t'i nënshtrohen standardit të njëjtë të vlerësimit. Pranimi i një dokumentacioni teknik kontradiktor nga GOE-ja e rekomanduar për kontratë dhe arsyetimi i përmbushjes së kërkesave përmes një mostre të paraqitur më pas e vendos këtë operator në pozitë më të favorshme kundrejt operatorëve të tjerë që kanë qenë të obliguar t'i dëshmojnë specifikat teknike me dokumentacionin e ofertës. Kriteri i çmimit më të ulët mund të zbatohet vetëm ndërmjet ofertave të përgjegjshme. Fakti që GOE-ja e rekomanduar ka ofertuar çmimin më të ulët nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që fillimisht të konstatojë se oferta e tij i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Një ofertë me çmim më të ulët, por e papërgjegjshme teknikisht, nuk mund të rekomandohet ligjërisht për kontratë vetëm për shkak të avantazhit financiar.

Mospërputhjet në vizatimet teknike dhe specifikat e kontejnerëve 1.1 mł

Të njëjtat mospërputhje dhe parregullsi në dokumentacionin teknik evidentohen edhe te kontejneri metalik me kapacitet 1.1 mł.

Konkretisht, në katalogun e dorëzuar dhe të nënshkruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë (GOE), janë deklaruar dimensionet 1360 × 985 × 1410 mm. Ndërkaq, në vizatimin teknik të paraqitur në të njëjtin dokumentacion, përkatësisht në dokumentin me numër rendor 4.1, paraqiten dimensione të ndryshme, përkatësisht 1420 × 1020 × 1420

mm.

Pra, edhe në këtë rast kemi mospërputhje të qarta ndërmjet dimensioneve të deklaruara në katalogun e nënshkruar nga vetë GOE-ja dhe atyre të paraqitura në vizatimin teknik të bashkëngjitur në të njëjtin dokument.

Për më tepër, mospërputhjet nuk përfundojnë vetëm në dokumentacionin e dorëzuar nga GOE-ja. Në dokumentin me numër rendor 14, ku janë paraqitur specifikat teknike të prodhuesit nga i cili ky grup i operatorëve ekonomikë ka siguruar autorizimin për shitjen e produkteve në kuadër të këtij tenderi, evidentohen përsëri dallime të konsiderueshme në dimensionet e kontejnerit 1.1 mł.

Konkretisht, në faqen nr. 1 të specifikave teknike të prodhuesit, lartësia e kontejnerit është paraqitur 1288 mm, ndërsa në katalogun e dorëzuar dhe të nënshkruar nga GOE-ja është deklaruar lartësia 1410 mm.

Po ashtu, sa i përket dimensionit të gjerësisë (Depth), prodhuesi ka specifikuar dimensionin 950 mm, ndërsa në katalogun e GOE-së është deklaruar dimensioni 985 mm. Ndërsa dimensioni i gjatësisë nuk është paraqitur në mënyrë të qartë në dokumentacionin e prodhuesit, duke pamundësuar një krahasim të saktë edhe për këtë dimension.

Nga sa më sipër, rezulton se ekzistojnë mospërputhje ndërmjet tri burimeve të ndryshme të dokumentacionit teknik: katalogut të nënshkruar nga GOE-ja, vizatimit teknik të paraqitur në dokumentin me numër rendor 4.1 dhe specifikave teknike origjinale të prodhuesit, nga i cili GOE-ja ka siguruar autorizimin për shitje.

Këto dallime nuk mund të konsiderohen si pasaktësi të parëndësishme dokumentare, pasi kanë të bëjnë drejtpërdrejt me karakteristikat dhe dimensionet fizike të produktit të ofruar, të cilat duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të njëjta në të gjithë dokumentacionin teknik të dorëzuar në kuadër të tenderit.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, përkatësisht Komisioni për Ekzaminimin dhe Vlerësimin e Tenderëve, nuk i ka identifikuar dhe trajtuar këto mospërputhje gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N.P.T. HAXHIJAHA SH.P.K. konsideron se kjo menyre vleresuese e demton kompanine tone e cila ka pervoje shum vjeqare ne furnizim e ne kete menyr na

pamundeson ushtrimin e aktivitetit ekonomike e ne te cilat eshte investuar ne staf te trajnuar. Demet tjeter material konsiston ne koston e pergaditjes se tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*